14. Metoda sipas pretendimit 10, ku virusi i bimës është *virusi spiral i gjethes së verdhë të domates*.

(11) **10354**

(97) EP3389633 / 14/07/2021

(96) 16875074.3 / 30/01/2016

(22) 30/07/2021

(21) AL/P/ 2021/565

(54) **PËRBËRJE FARMACEUTIKE QË PËRMBAJNË DERIVAT TË FENILAMINOPIRIMIDINËS**

05/10/2021

(30) 6951CH2015 18/12/2015 IN

(71) NATCO PHARMA LTD

Natco House Road No. 2 Banjara Hills, Hyderabad 500034, IN

(72) PARVATANENI, Durga Maheswari (Natco HouseRoad No.2Banjara Hills, Hyderabad 500034); APPADWEDULA, Venkata Satyanarayana (Natco HouseRoad No.2Banjara Hills, Hyderabad 500034); ADIBHATLA, Kali Satya Bhujanga Rao (Natco HouseRoad No.2Banjara Hills, Hyderabad 500034); NANNAPANENI, Venkaiah Chowdary (Natco HouseRoad No.2Banjara Hills, Hyderabad 500034); MOHANTY, Mitrabhanu (Natco HouseRoad No.2Banjara Hills, Hyderabad 500034)

(74) Arben Kryeziu

Rr. Idriz DOLLAKU, Pall.5, Shk.2, Ap.39, Tirane, AL

(57)

1. Formulim i përshtatshëm për përdorim oral që përmban një sasi terapeutikisht efektive të (3,5-Bis trifluorometil)-N-[4-metil-3-(4-piridin-3il-pirimidin-2-il-amino)fenil]benzamid (NRC-AN-019) ose një kripë të tij, dhe të paktën një agjent të matriksit polimerik, ku:

formulimi është në formën e tretësirës solide; dhe
agjenti i matriksit polimerik është një polimer jonik ose një polimer jo-jonik ose një kombinim i tyre, ku polimeri jonik është një polimer celozik ose një kopolimer i acidit metakrilik ose një kombinim i tyre, dhe ku polimeri jo-jonik është një polimer celulozik.

2. Formulimi siç pretendohet në pretendimin 1, ku NRC-AN-019 ka formë amorfe ose kristaline ose një kombinim të tyre, e preferueshme, kur NRC-AN-019 është në Formën kristaline I, Formën II, Formën III ose një kombinim i tyre.
3. Formulimi siç pretendohet në çdonjerin prej pretendimeve të mësipërme, ku raporti i NRC-AN-019 me agjentin e matriksit polimerik është nga 1:1 deri 1:8 të peshës totale të përbërjes.
4. Formulimi siç pretendohet në çdonjerin prej pretendimeve të mësipërme, ku polimeri jonik është një kombinim i një polimeri celulozik dhe një kopolimeri të acidit metakrilik.
5. Formulimi siç pretendohet në çdonjerin prej pretendimeve të mësipërme, ku kopolimeri i acidit metakrilik përzgjidhet nga poli(acid metakrilik, metil metakrilat), poli(acid metakrilik, etil akrilat) dhe një kombinim i tyre.
6. Formulimi siç pretendohet në çdonjerin prej pretendimeve të mësipërme, ku kopolimeri i acidit metakrilik është poli(acid metakrilik, metil metakrilat) dhe poli(acid metakrilik, etil akrilat).
7. Formulimi siç pretendohet në çdonjerin prej pretendimeve të mësipërme, ku tretësira solide përmban edhe një eksipient shtesë farmaceutikisht të pranueshëm të përzgjedhur nga mbartësat, mbushësat, surfaktantët, inhibitorët e kristalizimit, agjentët trashës, disintegrantët, plastifikuesit, de-shkumësuesat, antioksidantët, stabilizuesit, glidantët dhe lubrifikuesit.
8. Formulimi siç pretendohet në pretendimin 1, formulim i cili përbëhet nga:
 - (a) 1 pjesë NRC-AN-019, 2.5 pjesë Eudragit L 100 55, 4.5 pjesë HPMCAS (sucinat i acetatit hipromeloz) dhe 0.05 pjesë Karbopol 974;
 - (b) 1 pjesë NRC-AN-019, 2 pjesë Eudragit L 100 55, 1 pjesë Eudragit S 100 dhe 0.05 pjesë Karbopol 974;
 - (c) 1 pjesë NRC-AN-019, 2 pjesë Eudragit L 100 55, 1 pjesë Eudragit S 100 dhe 0.1 pjesë Karbopol 974;
 - (d) 1 pjesë NRC-AN-019, 4 pjesë Eudragit L 100 55, 2 pjesë Eudragit S 100 dhe 0.08 pjesë Karbopol 974;
 - (e) 1 pjesë NRC-AN-019, 5 pjesë Eudragit L 100 55 dhe 1 pjesë HPMCP HP-55 (ftalat hipromeloz);
 - (f) 1 pjesë NRC-AN-019, 5 pjesë Eudragit L 100 55, 1 pjesë Eudragit S 100, 1 pjesë HPMCAS (sukinat i acetatit hipromeloz) dhe 0.5 pjesë celulozë etili;

(g) 1 pjesë NRC-AN-019, 5 pjesë Eudragit L 100 55, 1 pjesë Eudragit S 100 dhe 1 pjesë HPMCP HP-55 (ftalat hipromeloze);

(h) 1 pjesë NRC-AN-019, 5 pjesë Eudragit L 100 55, 1 pjesë Eudragit S 100 dhe 1 pjesë HPMCP HP-55 (ftalat hipromeloze) dhe 0.5 pjesë celulozë etili.

9. Formulimi siç pretendohet në çdonjerin prej pretendimeve 1 deri 7, ku tretësira solide përftohet nga precipitimi i kontrolluar me anë të solventit, evaporimi (avullimi) i solventit, liofilizimi, precipitimi i kontrolluar nga pH, nxjerrja me shkrirje të nxehtë dhe teknologjia super kritike e fluidit.
10. Proçes për përfitim të tretësirës solide siç pretendohet në pretendimin 9, proçes i cili përfshin përzjerjen e NRC-AN-019 dhe një agjenti të matriksit polimerik siç përcaktohet në çdonjerin prej pretendimeve 1 dhe 4 deri 6 për të formuar një përzjerje homogjene të tretësirës nga ana molekulare.
11. Proçesi sipas pretendimit 10, ku përzjerja kryhet duke tretur NRC-AN-019 dhe agjentin e matriksit polimerik në një solvent organik, e ndjekur nga sprucimi në një anti-solvent dhe duke përfutur një ko-precipitat të NRC-AN-019 dhe një agjent të matriksit polimerik.
12. Proçesi sipas pretendimit 11, ku solventi është dimetilformamid, dimetilacetamid, dimetilsulfoksid dhe N-Metil-2-pirrolidon ose përzjerje e tyre, ose ku anti-solventi është ujë, acid hidroklorik, acetat etili, toluen, klorid metileni, acetonitril ose përzjerje e tyre.
13. Formulim siç përcaktohet në çdonjerin prej pretendimeve 1 deri 9 për t'u përdorur në terapi.
14. Formulim siç përcaktohet në çdonjerin prej pretendimeve 1 deri 9 për t'u përdorur në një metodë për trajtimin e kancerit.
15. Formulim për t'u përdorur sipas pretendimit 14 ku kanceri është myeloid leukemia kronike, kanceri i kokës, kanceri i qafës ose kanceri i prostatës.

(11) **10355**

(97) EP3256109 / 14/07/2021

(96) 16706551.5 / 09/02/2016

(22) 30/07/2021

(21) AL/P/ 2021/566

(54) **KOMPOZIMET FARMACEUTIKE QË PËRFSHIJNË N-(3,5-DIMETOKSILFENIL)-N'-(1-METILETIL)-N-[3-(1-METIL-1H-PIRAZOL-4-IL)KUINOKSALIN-6-IL]JETAN-1,2-DIAMIN**
05/10/2021

(30) 15154554 10/02/2015 EP and 15188982 08/10/2015 EP

(71) Astex Therapeutics Limited

436 Cambridge Science Park Milton Road, Cambridge Cambridgeshire CB4 0QA, GB

(72) BROGGINI, Diego Fernando Domenico (c/o Cilag AGHochstrasse 201, CH-8200 Schaffhausen)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)

(57)

1. Përdorimi i megluminës në një kompozim farmaceutik për të rritur qëndrueshmërinë kimike të N-(3,5-dimetoksifenil)-N'-(1-metiletil)-N-[3-(1-metil-1H-pirazol-4-il)kuinoksalin-6-il]etan-1,2-diamin, një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj ose një tretës i saj, i përmbajtur në kompozimin e sipërpërmendur.

2. Përdorimi i megluminës në një kompozim farmaceutik për të parandaluar, shtyrë, ngadalësuar ose zvogëluar transformimin e N-(3,5-dimetoksifenil)-N'-(1-metiletil)-N-[3-(1-metil-1H-pirazol-4-il)kuinoksalin-6-il]etan-1,2-diamin, një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj ose një tretës i saj, i përmbajtur në kompozim, në 6,8-dimetoksi-4-(1-metiletil)-1-[3-(1-metil-1H-pirazol-4-il)kuinoksalin-6-il]-2,3,4,5-tetrahidro-1H-1,4-benzodiazepin, një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj ose një tretës i saj.

3. Përdorimi sipas pretendimit 1 ose 2, ku kompozimi farmaceutik është një tablet ose një kapsulë.

4. Përdorimi sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 3, ku kompozimi farmaceutik përfshin bazë N-(3,5-dimetoksifenil)-N'-(1-metiletil)-N-[3-(1-metil-1H-pirazol-4-il)kuinoksalin-6-il]etan-1,2-diamin.

5. Një metodë e parandalimit, shtyrjes, ngadalësimit ose zvogëlimit të transformimit të N-(3,5-dimetoksifenil)-N'-(1-metiletil)-N-[3-(1-metil-1H-pirazol-4-il)kuinoksalin-6-il]etan-1,2-diamin, një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj ose një tretës i saj, i përmbajtur në një kompozim farmaceutik, në 6,8-dimetoksi-4-(1-metiletil)-1-[3-(1-metil-1H-pirazol-4-il)kuinoksalin-6-il]-2,3,4,5-tetrahidro-1H-1,4-benzodiazepin, një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj ose një tretës i saj, që përfshin shtim të megluminës në kompozimin e sipërpërmendur.

6. Metoda sipas pretendimit 5, ku kompozimi farmaceutik është një tablet ose një kapsulë.

7. Metoda sipas pretendimit 5 ose 6, ku kompozimi përfshin bazë N-(3,5-dimetoksifenil)-N-(1-metiletil)-N-[3-(1-metil-1H-pirazol-4-il)kuinoksalin-6-il]etan-1,2-diamin.

8. Një kompozim farmaceutik që përfshin N-(3,5-dimetoksifenil)-N'-(1-metiletil)-N-[3-(1-metil-1H-pirazol-4-il)kuinoksalin-6-il]etan-1,2-diamin, një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj ose një tretës i saj; megluminë; dhe një mbartës farmaceutikisht të pranueshëm.

9. Një kompozim farmaceutik sipas pretendimit 8 që përfshin nga 0.1 deri në 3 % w/w të megluminës.

10. Një kompozim farmaceutik sipas pretendimit 8 ose 9, ku kompozimi është një tablet ose një kapsulë.

11. Një kompozim farmaceutik sipas çdo njërit prej pretendimeve 8 deri në 10, ku kompozimi përfshin nga 0-2 % w/w të 6,8-dimetoksi-4-(1-metiletil)-1-[3-(1-metil-1H-pirazol-4-il)kuinoksalin-6-il]-2,3,4,5-tetrahidro-1H-1,4-benzodiazepin, një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj ose një tretës i saj.

12. Një kompozim farmaceutik sipas pretendimit 11, ku kompozimi përfshin 0-0.05 % w/w të 6,8-dimetoksi-4-(1-metiletil)-1-[3-(1-metil-1H-pirazol-4-il)kuinoksalin-6-il]-2,3,4,5-tetrahidro-1H-1,4-benzodiazepin, një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj ose një tretës i saj.

13. Një kompozim farmaceutik sipas çdo njërit prej pretendimeve 8 deri në 12 që përfshin nga 2 mg deri në 6 mg ekuivalente me bazën e N-(3,5-dimetoksifenil)-N'-(1-metiletil)-N-[3-(1-metil-1H-pirazol-4-il)kuinoksalin-6-il]etan-1,2-diamin, një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj ose një tretës i saj.

14. Një kompozim farmaceutik sipas çdo njërit prej pretendimeve 8 deri në 13, ku kompozimi përfshin bazë N-(3,5-dimetoksifenil)-N'-(1-metiletil)-N-[3-(1-metil-1H-pirazol-4-il)kuinoksalin-6-il]etan-1,2-diamin.

15. Një kompozim farmaceutik sipas pretendimit 10 i cili është i veshur me film me një veshje filmike me bazë uji.

16. Një kompozim farmaceutik sipas pretendimit 15 ku veshja e filmit me bazë uji është një sistem i çlirimit të menjëhershëm i bazuar në PVA, pa polietilen glikol.

17. Një kompozim farmaceutik sipas çdo njërit prej pretendimeve 8 deri në 14 për përdorim në trajtimin e kancerit, ku ilaçi duhet të administrohet çdo ditë për 3 javë (3 javë në vazhdim), e ndjekur nga 1 javë ku kompozimi nuk administrohet (1 javë pushim), dhe duke përsëritur këtë cikël prej 3 javësh në vazhdim, 1 javë pushim.

18. Një kompozim farmaceutik sipas çdo njërit prej pretendimeve 8 deri në 14 për përdorim në trajtimin e kancerit, ku ilaçi duhet të administrohet çdo ditë për 1 javë (1 javë në vazhdim), e ndjekur nga 1 javë ku

kompozimi nuk administrohet (1 javë pushim), dhe duke përsëritur këtë cikël prej 1 javë në vazhdim, 1 javë pushim.

19. Një kompozim farmaceutik sipas çdo njërit prej pretendimeve 8 deri në 14 për përdorim në trajtimin e kancerit, ku kompozimi administrohet çdo ditë.

20. Një kompozim farmaceutik sipas pretendimit 19 për përdorim në trajtimin e kancerit, ku kompozimi administrohet një herë në ditë.

21. Një kompozim farmaceutik sipas çdo njërit prej pretendimeve 17 deri në 20,

- (i) për përdorim në trajtimin e kancerit, ku doza ditore është 6 mg ekuivalente me bazën;
- (ii) për përdorim në trajtimin e kancerit, ku doza ditore është 7 mg ekuivalente me bazën;
- (iii) për përdorim në trajtimin e kancerit, ku doza ditore është 8 mg ekuivalente me bazën; ose
- (iv) për përdorim në trajtimin e kancerit, ku doza ditore është 9 mg ekuivalente me bazën.

22. Një kompozim farmaceutik sipas çdo njërit prej pretendimeve 17 deri në 21

- (i) për përdorim në trajtimin e kancerit, ku kanceri është kancer i fshikëzës;
- (ii) për përdorim në trajtimin e kancerit ku kanceri është kancer urotelial;
- (iii) për përdorim në trajtimin e kancerit ku kanceri është kancer urotelial metastatik;
- (iv) për përdorim në trajtimin e kancerit ku kanceri është kancer urotelial kirurgjikal i parezistueshëm;
- (v) për përdorim në trajtimin e kancerit ku kanceri është kolangjiokarcinoma; ose
- (vi) për përdorim në trajtimin e kancerit ku kanceri është kancer i fshikëzës jo-muskul-invaziv.

23. Një kompozim farmaceutik sipas pretendimit 22, pjesët (ii) deri në (vi) për përdorim në trajtimin e kancerit, ku kanceri është një kancer me ndryshime gjenomike FGFR.

24. Një kompozim farmaceutik sipas pretendimit 23 për përdorim në trajtimin e kancerit, ku ndryshimet gjenomike FGFR janë zhvendosje, shkrirje dhe/ose mutacione.

25. Një kompozim farmaceutik sipas pretendimit 24 për përdorim në trajtimin e kancerit, ku ndryshimi është një zhvendosje FGFR3-TACC3.

26. Një kompozim farmaceutik sipas pretendimit 24 për përdorim në trajtimin e kancerit, ku ndryshimi është një mutacion.

27. Një kompozim farmaceutik sipas pretendimit 26 për përdorim në trajtimin e kancerit, ku mutacioni është R248C.

28. Një kompozim farmaceutik sipas pretendimit 26 për përdorim në trajtimin e kancerit, ku mutacioni është S249C.

29. Një kompozim farmaceutik sipas çdo njërit prej pretendimeve 17 deri në 21 për përdorim në trajtimin e kancerit ku kanceri është kancer i përparuar ose rezistent i qelizave jo të vogla të mushkërisë (NSCLC), kancer i gjirit, glioblastoma multiforme, kanceri urotelial, kanceri i vezoreve, kanceri i kokës dhe i qafës, kanceri i ezofagut, kanceri gastrit dhe kolangjiokarcinoma.

30. Një kompozim farmaceutik sipas çdo njërit prej pretendimeve 17 deri në 21 për përdorim në trajtimin e kancerit ku kanceri është mielomë e shumëfishtë, çrregullime mieloproliferative, kanceri endometrial, kanceri i prostatës, kanceri i fshikëzës, kanceri i mushkërive, kanceri i vezoreve, kancer i gjirit, kanceri gastrit, kanceri kolorektal, dhe karcinoma e qelizave skuamoze orale.

31. Një kompozim farmaceutik sipas çdo njërit prej pretendimeve 17 deri në 21 për përdorim në trajtimin e kancerit ku kanceri është kancer endometrial, i vezoreve, gastrit, hepatoqelizor, i mitrës, qafës së mitrës dhe kolorektal.

32. Një kompozim farmaceutik sipas çdo njërit prej pretendimeve 17 deri në 21 për përdorim në trajtimin e një gjendje sëmundjeje ose gjendje të ndërmjetësuar nga një kinazë FGFR.

(11) **10356**

(97) EP3408260 / 05/05/2021

(96) 17712605.9 / 07/03/2017

(22) 30/07/2021

(21) AL/P/ 2021/567

(54) **ACIDI KRISTALORE (2S,4R)-5-(5'-KLUORO-2-FLUORO-[1,1'-BIFENIL]-4-YL)-2-(ETOKSIMETIL)-4-(3-HIDROKSOISOKSAZOLE-5-KARBOKSAMIDO)-2-METILPENTANOIK DHE PËRDORIMET E TIJ**

05/10/2021

(30) 201662305393 P 08/03/2016 US and 201662346336 P 06/06/2016 US

(71) Theravance Biopharma R&D IP, LLC

901 Gateway Boulevard, South San Francisco, CA 94080, US

(72) FLEURY, Melissa (47D Joy Avenue, Brisbane, California 94005); HUGHES, Adam D. (2029 Touraine Lane, Half Moon Bay, California 94019); THALLADI, Venkat R. (888 Foster City Boulevard Apt. E3, Foster City, California 94404); RAPTA, Miroslav (1240 Highland Court, San Carlos, California 94070); FASS, Gene Timothy (998 Burnett Avenue, San Francisco, California 94131); SIMEONE, Michael (75 Heather Avenue 6, San Francisco, California 94118); BALDWIN, R. Michael (1720 2nd Avenue, San Mateo, California 94401); BOURDET, David L. (614 Bayview Avenue, Millbrae, California 94030)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)

(57)

1. Një formë acidi e lirë kristalorë e acidit (2S,4R)-5-(5'-chloro-2'-fluoro-[1,1'-biphenyl]-4-yl)-2-(ethoxymethyl)-4-(3-hydroxyisoxazole-5-carboxamido)-2-methylpentanoic (I'), ku forma kristalorë është **karakterizuar nga** një model difraksioni x-rreze pluhur që përfshin majat e difraksionit në vlera 2θ të 6.51±0.20, 11.62±0.20, 13.05±0.20, 15.07±0.20, dhe 23.28±0.20.

2. Forma kristalorë e Pretendimit 1, ku forma kristalorë është **karakterizuar nga** një model difraksioni x-rreze pluhur që përfshin maja difraksioni në vlera 2θ të 6.51±0.20, 11.62±0.20, 13.05±0.20, 15.07±0.20, 17.12±0.20, 23.28±0.20, dhe 26.19±0.20.

3. Forma kristalorë e Pretendimit 1, ku modeli i difraksionit x-rreze pluhur përfshin më tej një ose më shumë maja difraksioni shtesë në vlerat 2θ të zgjedhura nga 15.72±0.20, 17.12±0.20, 20.79±0.20, 21.10±0.20, 24.48±0.20, 25.81±0.20, dhe 26.19±0.20.

4. Forma kristalorë e Pretendimit 1, ku forma kristalorë është **karakterizuar nga** një gjurmë kalorimetrie e skanimit diferencial e regjistruar me një shpejtësi ngrohjeje prej 10 °C për minutë, e cila tregon një maksimum në rrjedhën endotermike të nxehtësisë në një temperaturë midis rreth 214 °C dhe rreth 218 °C.

5. Një përbërje farmaceutike që përfshin formën kristalorë të secilit prej Pretendimeve 1 deri 4 dhe një transportues të pranueshëm farmaceutikisht.

6. Përbërja farmaceutike e Pretendimit 5, ku transportuesi i pranueshëm farmaceutikisht është magnez stearate.

7. Një përbërje farmaceutike që përfshin formën kristalorë të secilit prej Pretendimeve 1 deri 4 dhe një antagonist receptor AT1, një frenues fosfodiesteraze, një frenues renin, një frenues ciklase guanylate, një antagonist mineralokortikoidreceptor, një diuretik, ose kombinimet e tyre.

8. Përbërja farmaceutike e Pretendimit 7, që përfshin më tej një transportues të pranueshëm farmaceutikisht.

9. Një formë dozimi oral që përfshin formën kristalorë të secilit prej Pretendimeve 1 deri në 4 në një kapsulë, tablet ose suspension.

10. Forma e dozimit oral e Pretendimit 9, ku një çlirim i formës kristalorë në një subjekt është një çlirim i menjëhershëm, i kontrolluar ose i vonuar.

11. Forma e dozimit oral e Pretendimit 9, ku materiali i kapsulës është xhelatin, polisakaride, kitosan ose polimere sintetike.

12. Forma e dozimit oral e Pretendimit 9, ku kapsula është një kapsulë e fortë që përfshin xhelatin, polisakaride, ose polimerë sintetike.

13. Forma e dozimit oral e Pretendimit 9, ku kapsula përfshin hidroksipropil metilcelulozë.

14. Një formë kristalorë sipas secilit prej Pretendimeve 1 deri 4 për përdorim në terapi.

15. Një formë kristalore sic pretendohet në Pretendimin 14, për përdorim në trajtimin e hipertensionit, atakut të zemrës, ose sëmundjes renale.
16. Përdorimi i formës kristalore sipas secilit prej Pretendimeve 1 deri 4, për prodhimin e një medikamenti për trajtimin e hipertensionit, atakut të zemrës, ose sëmundjes renale.
17. Forma kristalore për përdorim sipas Pretendimit 15, ku hipertensionit është hipertension parësor, hipertension arterial pulmonar, hipertension pulmonar tromboembolik kronik, ose hipertension me stenoze të arteries renale.
18. Forma kristalore për përdorim sipas Pretendimit 15, ku sëmundja renale është nefropati diabetike, sëmundje kronike e veshkave, proteinuri, dëmtim akut i veshkave, sindroma nefrotike, glomerulosklerozë segmentale fokale ose sëmundje policistike e veshkave.
19. Forma kristalore për përdorim siç pretendohet në Pretendimin 15, ku forma kristalore i administrohet pacientit çdo ditë.
20. Forma kristalore për përdorim sipas Pretendimit 19, për përdorim në trajtimin e hipertensionit, atakut të zemrës ose një pacienti me dëmtim të veshkave, ku pacienti me dëmtim të veshkave ka sëmundje kronike të veshkave me një normë të vlerësuar të filtrimit glomerular (eGFR) ndërmjet 60 mL/min/1.73 m² dhe 15 mL/min/1.73 m².
21. Forma kristalore për përdorim sipas secilit prej Pretendimeve 15 ose 19, ku forma kristalore administrohet në mënyrë parenterale.
22. Një proces për përgatitjen e formës kristalore të Pretendimit 1, procesi që përfshin: (a) formimin e një solucionit që përfshin (2S,4R)-5-(5'-kloro-2'-fluoro-[1,1'-bifenil]-4-yl)-2-(etoksimetil)-4-(3-hidroksisoksazole-5-karboksamido)-2-acid metilpentanoik dhe një tretës, opsionalisht me një pastrues metalik, në një temperaturë të ngritur; (b) ftohja e solucionit në një temperaturë midis -20 °C dhe 5 °C; dhe (c) izolimi i lëndëve të ngurta që rezultojnë për të dhënë formën kristalore.
23. Prosesi sipas Pretendimit 22, (a) ku tretësi në hapin (a) është një tretës polar, për shembull, një përzierje e etil acetatit dhe ujit, etil acetatit, ose etanolit; ose (b) kur temperatura në hapin (a) është midis rreth 60 °C dhe 95 °C, për shembull, midis rreth 70 °C dhe 85 °C; ose (c) kur izolimi i trupave të ngurtë në hapin (c) përfshin filtrim, larje me një ose më shumë tretës, tharje në ajër ose nën vakum, ose një kombinim i këtyre hapave, për shembull, kur tretësi është acetat etil dhe ujë, etil acetat ose etanol; dhe/ose për shembull, kur tharja nën vakum kryhet në një temperaturë midis 25 °C dhe 70 °C.

(11) **10357**

(97) EP3582796 / 26/05/2021

(96) 18707154.3 / 12/02/2018

(22) 02/08/2021

(21) AL/P/ 2021/568

(54) **PËRBËRJE PËR KOLLËN**

06/10/2021

(30) 201700016964 15/02/2017 IT

(71) Aboca S.p.A. Società Agricola

Frazione Aboca 20, 52037 Sansepolcro (AR), IT

(72) MERCATI, Valentino (c/o Aboca S.p.A. Società Agricola Frazione Aboca 20, 52037 Sansepolcro

(AR)); POLENZANI, Paola (c/o Aboca S.p.A. Società Agricola Frazione Aboca 20, 52037 Sansepolcro

(AR)); MATTOLI, Luisa (c/o Aboca S.p.A. Società Agricola Frazione Aboca 20, 52037 Sansepolcro

(AR))

(74) Ela SHOMO PANIDHA

Euromarkpat Albania SH.P.K , Rr. A.Z. Çajupi, Pall. 20/4, Ap.15, Tiranë, 100

(57)

1. Një përbërje për tu përdorur në trajtimin e kollës, që përmban një ose më shumë fraksione polisakaridesh të plantainit, një ose më shumë fraksione polisakaridesh të marshmellous, një ose

më shumë fraksione polifenolike të agrimonit që përmbajnë tanina, sheqer kaf, mjaltë dhe një ose më shumë transportuesa dhe/ose mbushësa farmaceutikisht të pranueshëm, ku të përmendurit një ose më shumë fraksione polifenolike të agrimonit që përmbajnë tanina përmbajnë polifenole në një përqindje në peshë më të madhe se ose të barabartë me 3%.

2. Përbërja për tu përdorur sipas pretendimit 1, ku një ose më shumë fraksione polisakaridesh të plantainit përmbajnë polisakaride që kanë një peshë molekulare më të madhe se 20000 Daltonë në një përqindje në peshë më të madhe se ose të barabartë me 3%.
3. Përbërja për tu përdorur sipas pretendimit 1 ose sipas pretendimit 2, ku të përmendurit një ose më shumë fraksione polisakaridesh të marshmellous përmbajnë polisakaride që kanë një peshë molekulare më të lartë se 20000 Daltonë në një përqindje në peshë më të madhe se ose të barabartë me 5%.
4. Përbërja për përdorim sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 3, ku mbushësit e përmendur janë përzgjedhur nga aromatizuesat, konservuesat, agjentë trashës natyrorë.
5. Përbërja për tu përdorur sipas pretendimit 4, ku të përmendurit një ose më shumë aromatizuesat, konservuesat, agjentë trashës janë përzgjedhur nga lëngu i limonit, lëngu i manaferrës, aroma natyrale e portokallit, aroma natyrale e limonit, aroma natyrale e mersinës, goma ksantan.
6. Përbërja për tu përdorur sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 5, ku ekstraktet e përmendura janë në formë të liofilizuar ose spërkatësi të thatë.
7. Përbërja për tu përdorur sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 6 në formën e tabletës, pilulës, grimcave, pudrës, shurupit, eliksirit, xhelatinës së fortë, xhelatinës së butë, pezullit, spërkatësit, emulsionit, tretësirës.
8. Përbërja për tu përdorur sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 7, **karakterizuar në atë që** ajo ka një përqindje të mukongjitjes, të matur me një frenim të lidhjes së lektinës prej ndërmjet 85% dhe 50% kur nuk hollohet ose hollohet deri në një maksimum prej 1:5.
9. Përbërja për tu përdorur sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 8, ku trajtimi i përmendur është një trajtim për kollë të thatë, kollë produktive, kollë e shoqëruar me ITRS (infeksione të traktit respirator të sipërm), kollë të shkaktuar pas pikimit nazal.
10. Një proces për përgatitjen e një përbërjeje që konsiston në fraksionin/et polisakarid të plantainit, fraksionin/et polisakarid të marshmellous, fraksionin/et poliefonolik që përmban tanina të agrimonit, sheqerit kaf, mjaltit dhe një ose më shumë transportuesa dhe mbushësa farmaceutikisht të pranueshëm, ku fraksioni/et e polisakaridit, fraksioni/et e marshmello, fraksioni/et polifenolike të agrimonit që përmbajnë tanina ashtu siç përcaktohet në pretendimin 1 janë përzier me mjaltë, sheqer kaf dhe një ose më shumë mbushësa ose transportuesa farmaceutikisht të pranueshëm.

(11) **10358**

(97) EP3347061 / 19/05/2021

(96) 16763035.9 / 08/09/2016

(22) 02/08/2021

(21) AL/P/ 2021/569

(54) **HIDROXHELE MAKROPOROZE TË INJEKTUESHME**

06/10/2021

(30) 15184552 09/09/2015 EP

(71) ETH Zürich

Rämistrasse 101, 8092 Zürich, CH

(72) ZENOBI-WONG, Marcy (Kürbergstrasse 3, 8049 Zurich) ;BROGUIERE, Nicolas (Hohlstrasse 347, 8004 Zurich)

(74) Ela SHOMO PANIDHA

Euromarkpat Albania SH.P.K , Rr. A.Z. Çajupi, Pall. 20/4, Ap.15, Tiranë, 100

(57)

1. Një metodë për të siguruar një hidroxhel makroporoz, që përmban hapat e

a) sigurimin e një tretësire ujore që përmban një solucion të parë dhe të dytë, ku

i) solucioni i parë është një polimer i ndërlidhshëm i përzgjedhur nga një derivat i ndërlidhshëm i një glikol polietileni (PEG) dhe një derivat i ndërlidhshëm i një polioksazoline (POx);

dhe

ii) solucioni i dytë është një agjent kozmotropik polisakarid i përzgjedhur nga grupi që përmban hialuronan, manuronan, karrageenan, heparinë, sulfat kondroitine, dekstran, hidroksipropil dekstran, pektinë, alginat, gomë gelani, celulozë, metilcelulozë, etilcelulozë, acetat celuloze, niseshte dhe niseshte hidroksipropili, ku përqendrimi i agjentit kozmotropik polisakarid të përmendur në tretësirën ujore të përmendur është 0.1 deri në 50% (w/v); dhe

b) shtimin tek përzierja e përmendur të një reagenti të ndërlidhshëm të aftë të ndërlidhë polimerin e ndërlidhshëm të përmendur, nderkohe qe fillon xhelatimin ne menyre te njëkohshme të polimerit të ndërlidhshëm të përmendur dhe të fazës së ndarjes.

2. Metoda sipas pretendimit 1, ku polimeri i ndërlidhshëm i përmendur është përzgjedhur nga

a) grupi që përmban një glikol polietileni linear ose në formë ylli, një kopolimer di-blok glikol polietileni dhe një kopolimer tri-blok glikol polietileni; ose

b) grupi që përmban një polimetiloksazolinë, një polietiloksazolinë, një polipropiloksazolinë dhe një polibutiloksazolinë; ose

c) grupi që përmban një polioksazolinë të drejtë ose në formë ylli dhe një kopolimer të oksazolinës; ose

d) grupi që përmban oksazolinë poli 2-metil të hidrolizuar pjesërisht ose oksazolinë poli 2-etil;

e) një kopolimer diblok glikol polietileni që konsiston në blloqe të dy monomerëve, ku njëri është glikol polietileni, dhe tjetri është përzgjedhur nga grupi që përmban polietilen (PE), polilaktid (PLA), polilaktid-ko-glikolid (PLGA), poli-ε-kaprolakton (PCL) dhe polistiren

f) një kopolimer triblok glikol polietileni që konsiston në blloqe me dy monomere, ku njëri është glikol polietileni, tjetri është përzgjedhur nga glikol poliprolileni (PPG) dhe polilaktid-ko-glikolidi (PLGA).

3. Metoda sipas secilit prej pretendimeve të mëposhtme, ku polimeri i ndërlidhshëm i përmendur përmban një fragment reaktiv të përzgjedhur nga grupi që përmban akrilat, metakrilat, akrilamid, ester vinili, maleimid, sulfon vinili, alkin, azid, aldehid dhe fragmente tioli.

4. Metoda sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku polimeri i ndërlidhshëm i përmendur është sulfon vinili i modifikuar dhe reagenti i ndërlidhshëm i përmendur është përzgjedhur nga grupi që përmban
 - a) një molekulë bashkuese të shkurtër që përmban dy fragmente (-SH) tioli; dhe
 - b) një glikol polietileni me formë ylli që përmban fragmente (-CH₂SH)tioli parësore ose një glikol polietileni të drejtë që përmban fragmente (-CH₂SH) tioli parësore; dhe
 - c) një peptid që përmban dy deri në njëqind aminoacide, ku dy nga aminoacidet e përmendura janë cisteina; dhe
 - d) proteina që përmbajnë dy cisteina.
5. Metoda sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku pesha molekulare e polimerit të ndërlidhshëm është 1,000 deri në 1,000,000 g/mol.
6. Metoda sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku përqendrimi i polimerit të ndërlidhshëm të përmendur në tretësirën ujore të përmendur është 0.5 deri në 10% (w/v).
7. Metoda sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku tretësira ujore e përmendur përmban 0.5 deri në 3% (w/v) të derivatit të ndërlidhshëm të përmendur të një glikol polietileni ose 4 deri në 10% (w/v) të derivatit të ndërlidhshëm të përmendur të një polioksazoline.
8. Metoda sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku agjenti kozmotropik polisakarid është një polisakarid i përzgjedhur nga grupi që përmban pektinë, alginat, gomë gelani, celulozë, hialuronan, manuronan dhe dekstran, dhe ku polisakaridi i përmendur **karakterizohet nga një** peshë molekulare që varion nga 1,000 g/mol deri në 10,000,000 g/mol, veçanërisht 10,000 g/mol deri në 2,000,000 g/mol, akoma më veçanërisht 100,000 g/mol deri në 1,000,000 g/mol, akoma dhe më veçanërisht afërsisht 150,000 g/mol.
9. Metoda sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku përqendrimi i agjentit kozmotropik polisakarid të përmendur në tretësirën ujore të përmendur është 0.1 deri në 5% (w/v).
10. Metoda sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 8, ku tretësira ujore e përmendur përmban 0.1 deri në 1% hialuronan, ose 0.5 deri në 5% manuronan, ose 0.1 deri në 20% dekstran, ose një përzierje të tyre.
11. Metoda sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku polimeri i ndërlidhshëm i përmendur është PEG-tiol-4-krahësh 20 kDa i modifikuar me fragmente vinilsulfoni, ku polisakaridi i përmendur është manuronan, dhe reagenti i ndërlidhshëm i përmendur është një peptid i ndashëm nga metaloproteinaza e matricës.
12. Metoda sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku tretësira ujore e përmendur **karakterizohet nga** një pH prej 7.0-8.0 dhe shtimi i agjentit ndërlidhës të përmendur ndodh në 20°C deri në 40°C.
13. Metoda sipas secilit prej pretendimeve të mësipërme, ku një qelizë shtohet tek tretësira ujore e përmendur përpara ndërlidhjes.
14. Një hidroxhel makroporoz i përftuar ose i përftueshëm nga metoda e secilit prej pretendimeve 1 deri në 13.

(11) **10359**

(97) EP3319612 / 19/05/2021

(96) 16821926.9 / 06/07/2016

(22) 03/08/2021

(21) AL/P/ 2021/570

(54) **OKSISTEROLE DHE METODA TË PËRDORIMIT TË TYRE**

06/10/2021

(30) 201562189068 P 06/07/2015 US and 201662332931 P 06/05/2016 US

(71) Sage Therapeutics, Inc.

215 First Street, Cambridge, MA 02142, US

(72) SALITURO, Francesco, G. (25 Baker Drive, Marlborough, MA 01752); ROBICHAUD, Albert, Jean


(2 Earhart St. 915, Cambridge, MA 02141); MARTINEZ BOTELLA, Gabriel (17 Parmenter Road, Wayland, MA 01778) ;HARRISON, Boyd, L. (9 Wheatston Court, Princeton Junction, NJ 08550)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)

(57)

1. Një përbërje e Formulës (I):



ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj, ku:

R¹ është C₁₋₆ alkil i zëvendësuar ose i pazëvendësuar;

R² është karbociklil ose heterociklil;

R⁵ mungon ose është hidrogjen; dhe

— përfaqëson një lidhje të vetme ose të dyfishtë, ku kur një — është një lidhje e dyfishtë, tjetra — është një lidhje njëfishe

dhe R⁵ mungon;


ku secili shembull i një grup alkili është në mënyrë të pavarur i pazëvendësuar ose i zëvendësuar me një ose më shumë zëvendësues.

2. Përbërja e pretendimit 1, ku R¹ është C₁₋₆ alkil i zëvendësuar; R¹ është C₁₋₆ alkil i pazëvendësuar; R¹ është -CH₃, -CF₃, -CH₂OCH₃, ose -CH(CH₃)(CF₃), etil, ose izopropil; ose R¹ është metil ose etil.


3. Përbërja e pretendimit 1, ku R² është ciklopropil, ciklobutil, ciklopentil, cikloheksil; ose R² është një heterocikël që përmban oksigjen (p.sh., tetrahidropiran).

4. Përbërja e pretendimit 1, ku — përfaqëson një lidhje njëfishe.


5. Përbërja e pretendimit 1, ku përbërja e Formulës (I) është një përbërje e Formulës (I-A) ose Formulës (I-B):



6. Përbërja e pretendimit 1, ku përbërja e Formulës (I) është i një përbërje e Formulës (V):





ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj; ose një përbërje e Formulës (V-A) ose Formulës (V-B):





ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj.

7. Përbërja e pretendimit 1, ku përbërja e Formulës (I) është zgjedhur nga:









ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj.

8. Një kompozim farmaceutik që përfshin një përbërje të pretendimit 1, ose një kripë farmaceutikisht të pranueshme të saj, dhe një mbartës farmaceutikisht të pranueshëm.

9. Përbërja e pretendimit 1, për përdorim në terapi ose si një ilaç.

10. Përbërja e pretendimit 1, për përdorim në një metodë të nxitjes së qetësimit ose anestezisë, metoda që përfshin administrimin në një subjekt të një sasive efektive të një përbërjeje të pretendimit 1, ose një kripë farmaceutikisht të pranueshme të saj, ose një kompozim farmaceutik të saj.

11. Përbërja e pretendimit 1, për përdorim në një metodë për trajtimin ose parandalimin e një çrregullimi, ku çrregullimi është një çrregullim gastrointestinal (GI) *p.sh.*, kapsllëk, sindroma e zorrës së irrituar (IBS), sëmundja inflamatorë e zorrëve (IBD) (*p.sh.*, kolit ulcerativ, sëmundja e Crohn), çrregullime strukturore që prekin GI, çrregullime anale (*p.sh.*, hemorroide, hemorroide të brendshme, hemorroide të jashtme, çarje anale, absceza perianale, fistula anale), polipe të zorrës së trashë, kancer, koliti, diabet, ose një çrregullim i sintezës së steroleve, metoda që përfshin administrimin në një subjekt në nevojë të saj të një sasive efektive të një përbërjeje të pretendimit 1, ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj, ose një kompozim farmaceutik i saj.

12. Përbërja e pretendimit 1, për përdorim në një metodë për trajtimin ose parandalimin e një gjendje të lidhur me SNQ, metoda që përfshin administrimin në një subjekt në nevojë të saj të një sasive efektive të një përbërjeje të pretendimit 1, ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj, ose një kompozim farmaceutik i saj.

13. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 12, ku gjendja e lidhur me SNQ është një çrregullim i përshtatjes, çrregullim ankthi (që përfshin çrregullimin obsesiv kompulsiv, çrregullimin e stresit post-traumatik, dhe fobinë sociale), çrregullim i njohjes (që përfshin sëmundjen e Alzheimerit dhe forma të tjera të demencës), çrregullim disociativ, çrregullim i të ngrënit, çrregullim i humorit (që përfshin depresion (*p.sh.*, depresioni pas lindjes), çrregullimi bipolar, çrregullimi distimik, vetëvrasja), skizofrenia ose çrregullime të tjera psikotike (që përfshin çrregullimin skizoafektiv), çrregullimi i gjumit (që përfshin pagjumësinë), çrregullimi i lidhur me substanca, çrregullimi i personalitetit (që përfshin çrregullimin obsesiv kompulsiv të personalitetit), çrregullimet e spektrit të autizmit (që përfshin ato që përmbajnë mutacione në grupin e proteinave Shank (*p.sh.*, Shank3)), çrregullime neurozhvillimore (që përfshin sindromën Rett, kompleksin e Sklerozës Tuberoze), skleroza e shumëfishtë, çrregullime të sintezës së steroleve, dhimbje (që përfshin dhimbje akute dhe kronike), encefalopati dytësore në një gjendje mjekësore (që përfshin encefalopatinë hepatike dhe encefalitin e receptoreve anti-NMDA), çrregullimet e krizës (që përfshin statusin epileptik dhe forma monogjenike të epilepsisë si sëmundja e Dravet), goditje, dëmtime traumatike të trurit, çrregullim i lëvizjes (që përfshin sëmundjen e Huntingtonit dhe sëmundjen e Parkinsonit), dëmtim i shikimit, humbje e dëgjimit, dhe tringëllimë në vesh.

(11) **10360**

(97) EP3508196 / 14/07/2021

(96) 19154013.7 / 17/08/2015

(22) 03/08/2021

(21) AL/P/ 2021/571

(54) **KOMPOZIME TË PROMEDIKAMENTIT ARIPIPRAZOL**

06/10/2021

(30) 14181328 18/08/2014 EP and 201462038665 P 18/08/2014 US

(71) Alkermes Pharma Ireland Limited

Connaught House 1 Burlington Road, Dublin 4, D04 C5Y6, IE

(72) LIVERSIDGE, Elaine (250 Frist Avenue Unit 526, Charlestown, MA 02129); CRESSWELL, Philip (15 Pearse Court Pearse Street, Athlone); HICKEY, Magali (440 Pond Street, Westwood, MA 02090); MANSER, David (2 Mosstown Court, Keenagh County Longford); PALMIERI, Michael Jr. (179 South Street, Upton, MA 01568); PAQUETTE, Sara Montminy (11 Brigham Street Unit 15B, Hudson, MA 01749); PERKIN, Kristopher (23 Waterville Bealnamulla, Athlone Co. Roscommon); SMITH, Greg (134 John Scott Boulevard, Norton, MA 02766); STEINBERG, Brian (134 George Street, Arlington, MA 02476); TURNCLIFF, Ryan (21 Rossi Lane, Ashland, MA 01721); ZEIDAN, Tarek (499 Lowell Street, Lexington, MA 02420); CASH, Ethan P. (14 Ward Road, Sudbury, MA 01776); HARD, Marjie L. (10 Winter Street, Lexington, MA 02420)


(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)

(57)

1. Një metodë e përgatitjes së një kompozimi që përfshin (i) një popullatë të grimcave të një promedikamenti aripiprazol që ka një madhësi grimce të bazuar në vëllim (Dv50) prej midis 50 dhe 700 nm siç përcaktohet nga teknikat e shpërndarjes së dritës dhe (ii) të paktën një stabilizues të sipërfaqes që përfshin një komponent të absorbuar i cili është absorbuar në sipërfaqen e grimcave të promedikamentit aripiprazol dhe një komponent të lirë të disponueshëm për tretshmërinë e promedikamentit të

aripirazolit, ku raporti i peshës së promedikamentit të aripirazolit me stabilizuesin e sipërfaqes është midis 10:1 dhe 26:1, dhe ku promedikamenti aripirazol ka formulën:



ku n është zero ose një numër i plotë më pak se 20,

ku të paktën një stabilizues i sipërfaqes është zgjedhur nga grupi i përbërë prej karboksimetil celulozës dhe një ester i acidit yndyror polioksietilen sorbitan;

metoda që përfshin hapat e mëposhtëm:

- (a) llogaritja e një sasive e të paktën një stabilizuesi të sipërpërmendur për t'u shtuar në kompozim në mënyrë që të sigurohet që të dy një komponent i absorbuar dhe një komponent i lirë i stabilizuesit të sipërpërmendur janë të pranishëm në kompozim;
- (b) prodhimi i një popullate grimcash të promedikamentit aripirazol që ka një madhësi grimce të bazuar në vëllim (Dv50) prej midis 50 dhe 700 nm siç përcaktohet nga shpërndarja e dritës; dhe
- (c) kombinimi i sasisë së stabilizuesit të sipërfaqes me popullatën e grimcave të promedikamentit aripirazol, i tillë që komponenti i absorbuar i sipërfaqes së stabilizuar është absorbuar në sipërfaqen e grimcave të promedikamentit aripirazol.

2. Metoda e pretendimit 1, ku hapi (b) dhe hapi (c) kryhen njëkohësisht me bluarje të promedikamentit të aripirazolës me stabilizuesin e pranishëm.

3. Metoda e çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 2, që përfshin më tej:

- (d) mbajtjen e një mostre të kompozimit për testim të sasisë së komponentit të lirë të stabilizuesit të sipërfaqes;
- (e) ndarjen e grimcave të aripirazolës lauroksil dhe stabilizuesit të sipërfaqes së absorbuar nga mjedisi i shpërndarjes në mostër për të formuar një supernatant; dhe
- (f) matjen e sasisë së stabilizuesit të sipërfaqes në supernatant duke përdorur një aparat kromatografie të lëngët me performancë të lartë (HPLC).

4. Metoda e çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 3, që përfshin më tej hapin e:

- (g) kombinimit të grimcave të promedikamentit aripirazol dhe stabilizuesit të sipërfaqes me një medium shpërndarës për të formuar një kompozim të promedikamentit të shpërndarë aripirazol.

5. Metoda e çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 4, që përfshin më tej:

(h) kombinimin e grimcave të promedikamentit aripiprazol që ka një madhësi grimce të bazuar në vëllim (Dv50) prej midis 50 dhe 700 nm me një popullatë shtesë të grimcave të promedikamentit aripiprazol që ka një madhësi grimce të bazuar në vëllim (Dv50) të paktën 100 nm më të madhe në madhësi.

6. Metoda e çdo njërit prej pretendimeve 4 deri në 5, që përfshin më tej:

(i) mbushjen e kompozimit të promedikamentit të shpërndarë të aripiprazolës në një pajisje injektimi.

7. Metoda e pretendimit 6, ku pajisja e injektimit është një shiringë e mbushur paraprakisht.

8. Metoda e pretendimit 6, ku pajisja e injektimit është një auto-injektuese.

9. Metoda e pretendimit 6, ku pajisja e injektimit është një shiringë pa gjilpërë.

10. Metoda e pretendimit 6, ku pajisja e injektimit është një shiringë me dy dhoma.

11. Metoda e pretendimit 10, që përfshin më tej hapin e

(j) mbushjes së kompozimit të promedikamentit aripiprazol në një dhomë të shiringës me dy dhoma, dhe mbushjes së dhomës tjetër të shiringës me dy dhoma me një kompozim të dytë.

12. Metoda e pretendimit 11, ku kompozimi i dytë është një kompozim i dytë promedikamenti aripiprazole, që ka një madhësi grimce të bazuar në vëllim (Dv50) prej (a) më pak se 1000 nm, (b) midis 1000 dhe 5000 nm ose (c) më të madhe se 5000 nm.

13. Metoda e ndonjërit prej pretendimeve të mësipërme, ku hapi (b) kryhet duke bluar popullatën e promedikamentit të aripiprazolës.

14. Metoda e ndonjërit prej pretendimeve të mësipërme, ku hapi (a) kryhet në mënyrë të tillë që sasia e stabilizuesit të lirë është më e madhe se 0.0% (w/w) dhe më e vogël se 3.0% (w/w) të kompozimit.

15. Metoda e ndonjërit prej pretendimeve të mësipërme, ku raporti i peshës së promedikamentit aripiprazol me stabilizuesin e sipërfaqes është midis 15:1 dhe 20:1.

16. Metoda e ndonjërit prej pretendimeve të mësipërme, ku raporti i peshës së promedikamentit të me stabilizuesin e sipërfaqes është 17:1.

(11) **10361**

(97) EP3436437 / 19/05/2021

(96) 17714751.9 / 31/03/2017

(22) 03/08/2021

(21) AL/P/ 2021/573

(54) **DERIVATET E INDOLINËS SË ZËVENDËSUAR SI FRENUES TË REPLIKIMIT VIRAL TË ETHEVE TROPIKALE**

06/10/2021

(30) 16163488 01/04/2016 EP

(71) Janssen Pharmaceuticals, Inc. and Katholieke Universiteit Leuven

1125 Trenton-Harbourton Road, Titusville, NJ 08560, US ;KU Leuven Research & Development Waaistraat 6, Bus 5105, 3000 Leuven, BE


(72) BONFANTI, Jean-François (c/o Janssen-Cilag1 Rue Camille DesmoulinsTSA 91003, 92787 Issy-les-Moulineaux Cedex 9); RABOISSON, Pierre Jean-Marie Bernard (c/o Janssen Pharmaceutica NVTurnhoutseweg 30, 2340 Beerse); KESTELEYN, Bart Rudolf Romanie (c/o Janssen Pharmaceutica NVTurnhoutseweg 30, 2340 Beerse); BARDIOT, Dorothée Alice Marie-Eve (c/o Cistim Leuven vzwGaston Geenslaan 2, 3001 Leuven (Heverlee)) ;MARCHAND, Arnaud Didier M (c/o Cistim Leuven vzwGaston Geenslaan 2, 3001 Leuven (Heverlee))

(74) Krenar LOLOÇI


Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)


(57)

1. Një përbërje që ka formulën (I)









një formë stereoizomerike, një kripë, tretës ose polimorf farmaceutikisht i pranueshëm i saj, ku përbërjet janë zgjedhur nga grupi që përfshin:






2. Një kompozim farmaceutik që përfshin një përbërje sipas pretendimit 1 ose forma stereoizomerike e tij, një kripë, tretës ose polimorf farmaceutikisht i pranueshëm i tij së bashku me një ose më shumë eksipientë, hollues ose mbartës farmaceutikisht të pranueshëm.

3. Një përbërje sipas pretendimit 1 ose forma stereoizomerike e saj, një kripë, tretës ose polimorf farmaceutikisht i pranueshëm i saj ose një kompozim farmaceutik sipas pretendimit 2 për përdorim si një ilaç.
4. Një përbërje sipas pretendimit 1 ose forma stereoizomerike e saj, një kripë, tretës ose polimorf farmaceutikisht i pranueshëm i saj ose një kompozim farmaceutik sipas pretendimit 2 për përdorim në trajtimin e etheve tropikale.
5. Një përbërje siç përfaqësohet nga ndonjëra prej formulave strukturore nga pretendimi 1, një formë stereoizomerike, një kripë, tretës ose polimorf farmaceutikisht i pranueshëm i saj për përdorim në frenimin e replikimit të virusit(eve) të etheve tropikale në një mostër biologjike ose pacient.
6. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 5 që përfshin më tej bashkë-administrimin e një agjenti shtesë terapeutik.
7. Përbërja për përdorim e pretendimit 6 ku agjenti shtesë terapeutik i sipërpërmendur është zgjedhur nga një agjent antiviral ose vakcina e etheve tropikale, ose të dyja.
8. Përbërja siç pretendohet në pretendimin 1, ku përbërja është





ose një kripë, tretës ose polimorf farmaceutikisht i pranueshëm i saj.

9. Një kompozim farmaceutik që përfshin një përbërje sipas pretendimit 8, një kripë, tretës ose polimorf farmaceutikisht të pranueshëm të tij së bashku me një ose më shumë eksipientë, hollues ose mbartës farmaceutikisht të pranueshëm.

10. Një përbërje sipas pretendimit 8, një kripë, tretës ose polimorf farmaceutikisht i pranueshëm i saj ose një kompozim farmaceutik sipas pretendimit 9 për përdorim si një ilaç.

11. Një përbërje sipas pretendimit 8, një kripë, tretës ose polimorf farmaceutikisht i pranueshëm i saj ose një kompozim farmaceutik sipas pretendimit 9 për përdorim në trajtimin e etheve tropikale.

12. Një përbërje siç përfaqësohet nga ndonjëra prej formulave strukturore nga pretendimi 8, një kripë, tretës ose polimorf farmaceutikisht i pranueshëm i saj për përdorim në frenimin e replikimit të virusit(eve) të etheve tropikale në një mostër biologjike ose pacient.

13. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 12 e cila përfshin më tej bashkë-administrimin e një agjenti shtesë terapeutik.

14. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 13 ku agjenti shtesë terapeutik i sipërpërmendur është zgjedhur nga një agjent antiviral ose vaksina e etheve tropikale, ose të dyja.

(11) **10362**

(97) EP3609808 / 30/06/2021

(96) 18712816.0 / 12/03/2018

(22) 03/08/2021

(21) AL/P/ 2021/574

(54) **ENË SHPËRNDARËSE**

06/10/2021

(30) 102017121702 19/09/2017 DE

(71) INOTECH Kunststofftechnik GmbH

Boschstraße 3, 92507 Nabburg, DE

(72) GLEIXNER, Josef (Kapellenflecke 9, 92507 Nabburg)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)

(57)

1. Një enë shpërndarëse (1) që përbëhet prej një ene të jashtme (2) dhe një ene të brendshme (3) për të marrë një lëng, ku ena e jashtme (2) dhe ena e brendshme (3) janë të përfshira prej plastikë të formuar me goditje, të cilat nuk formojnë një lidhje materiale me njëra tjetrën, dhe një plastikë të parë nga e cila ena e brendshme (3) është formuar ka një elasticitet më të lartë se një plastikë e dytë nga e cila ena e jashtme (2) është formuar, ashtu që ena e brendshme (3) është e deformueshme, dhe ku ena e jashtme (3) përfshin të paktën një hapje të barazimit të presionit (4) për barazimin e presionit në zonën (25) mes enës së jashtme (2) dhe enës së brendshme (3),

ena e brendshme (3) përfshin një zonë të parë të gojës (6) dhe ena e jashtme (2) përfshin një zonë të dytë të gojës (7), ku zona e parë e gojës (6) mund të zhvendoset në krahasim me zonën e dytë të gojës (7) në drejtim të gojës (8),

karakterizuar në atë që

ena e brendshme (3) përfshin mbi një anë të jashtme të saj të paktën një projeksion të parë komplementar (9) për të mbyllur hapjen e barazimit të presionit (4), e cila del në hapjen e barazimit të presionit (4) dhe është lidhur me hapjen e barazimit të presionit (4) para zhvendosjes së zonës së parë të gojës (6) në krahasim me zonën e dytë të gojës (7), dhe projeksioni i parë (9) është shkëputur nga hapja e barazimit të presionit (4) pas zhvendosjes së zonës së parë të gojës (6).

2. Ena shpërndarëse (1) sipas pretendimit 1,

karakterizuar në atë që

zona e parë e gojës (6) zgjatet të paktën pjesërisht më tej në drejtimin e gojës (8) pastaj zonën e dytë të gojës (7).

3. Ena shpërndarëse (1) sipas njërit prej pretendimeve të mësipërme,

karakterizuar në atë që

